

VENDIM
Nr.3, datë 26.1.2005

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR DHËNIEN E LICENCËS,
PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI BANKARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 12 shkronja a dhe nenit 43 shkronja c të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 8 pika 1 të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.71, datë 11.9.2002, të bëhen ndryshimet si më poshtë:

“Në nenin 1, pikën 1.5 dhe pikën 1.6 vlefte prej 700 milionë lekësh të zëvendësohet me “1 miliardë lekë”.”

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ardian Fullani